



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1393_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2150_03_21** .

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET Pjesërisht** ankesa e konsumatorit B.T, nga komuna e Kaçanikut si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij rekomandimi.
- II. OBLIGOHET** KESCO që konsumatorit me shifër DFE – 9037112 t'i anulojë korrigjimin nr.41112DPR-9037112 të datës 27.08.2015 në vlerë 2,026.06€, si dhe faturat e periudhës 01/2015 deri në periudhën 05/2015.
- III. OBLIGOHET** KESCO që konsumatorit me shifër DFE – 9037112 për faturat e anuluar ta faturojë konsumatorin me shpenzimet e periudhës 01/2016 deri në periudhën 05/2016.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është parashtruar ankesa nga parashtruesi B.T me shifër **DFE – 9037112** me të cilën është kundërshtuar përgjigja e lëshuar nga KESCO lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr.41112DPR-9037112 të datës 27.08.2015.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 18.03.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar se konsumatori shkyçet në siguresa të trafos. Ekipi i KEDS-it nuk ka evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.35754660.

Provë: Procesverbal i inspektimit nr.1037636 i datës 18.03.2014

Me datë 02.04.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e grupeve matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.35754660, ku kanë evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse, por që nuk kanë evidentuar edhe gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në Grupin Matës nr.35754660. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që vendosen TMRR-të e reja të KEDS-it dhe bëhet mufizimi i tensioneve si dhe vulosja e tyre.

Provë: Procesverbal mbi kontrollimin -pranimin e grupit matës nr.004422 i datës 02.04.2015



Me datë 27.01.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar se konsumatori shkyçet në trafo për shkak të borxhit. Ekipi i KEDS-it nuk ka evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.35754660.

Provë: Procesverbali i inspektimit nr.1750106 i datës 27.01.2015

Me datë 10.07.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e grupeve matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja Grupin matës nr. 35754660 por nuk është evidentuar gjendja e shpenzimeve si dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr. 50882395 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Provë: Procesverbali i pranimit të grupit matës nr.000005 i datës 10.07.2015

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 27.08.2015 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr.41112DPR-9037112 në vlerë financiare **2,026.06€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 12/2014 deri në periudhën 06/2015.

Provë: Korrigjimi plotësues nr.41112DPR-9037112 i datës 27.08.2015

Me datë 14.12.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me qëllim të shkyçjes por që kanë evidentuar se konsumatori ka qenë i shkyçur dhe mbetet i shkyçur.

Provë: Procesverbali i inspektimit nr.0955607 i datës 14.12.2015

Me datë 28.08.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues nr.41112DPR-9037112 të datës 27.08.2015.

Provë: Ankesa e konsumatorit datë 28.08.2015

Me datë 23.11.2015 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalit të pranimit të grupit matës nr.000005 i datës 10.07.2015.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 23.11.2015

Me datë 15.02.2016 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar të shqyrtohet korrigjimi plotësues nr.41112DPR-9037112 datë 27.08.2015.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 10.07.2018

Bordi i ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga konsumatori dhe KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 18.03.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar se konsumatori shkyçet në siguresa të trafos. Ekipi i KEDS-it nuk ka evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr. 35754660.

Provë: Procesverbali i inspektimit nr.1037636 i datës 18.03.2014

Me datë 02.04.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e grupeve matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 35754660, ku kanë evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse, por që nuk kanë evidentuar edhe gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në GM nr.35754660. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që vendosen TMRR-të e reja të KEDS-it, bëhet mufizimi i tensioneve si dhe vulosja e tyre. Ekipi i KEDS-it nuk ka evidentuar nëse konsumatori mbetet i shkyçur apo është ri kyçur pas inspektimit dhe rregullimit të pikës matëse.

Provë: Procesverbali mbi kontrollimin pranimit të grupit matës nr.004422 i datës 02.04.2015

Me datë 27.01.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar se konsumatori shkyçet në trafo për shkak të borxhit. Ekipi i KEDS-it nuk ka evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr. 35754660.



Provë: Procesverbali i inspektimit nr.1750106 i datës 27.01.2015

Me datë 10.07.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e grupeve matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja Grupin matës nr.35754660 nuk është evidentuar gjendja e shpenzimeve si dhe kanë vendosur për matje Grupin matës nr.50882395 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal që njëhëni elektrik ka pasur të dëmtuar displayin dhe nuk ka mundur të lexohet dhe se duhet të bëhet korrigjimi i faturës sipas leximeve të AMR-së.

Provë: Procesverbali i pranimit të grupit matës nr.000005 i datës 10.07.2015

Bordi i ZRRE-së ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike, si dhe listat e leximit dhe konstaton se konsumatori ka lexime të rregullta mujore, por që për periudhën kontestuese 01-05/2015 konsumatori është faturuar vetëm me taksa pa shpenzim. Po ashtu vëren se edhe pas ndërrimit të njëhëni elektrik konsumatori për periudha të ndryshme nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike kurse në disa ka shpenzim të ulët e i cili nuk përputhet me shpenzimet e periudhës para ndërrimit të njëhëni elektrik nr.35754660. Bordi i ZRRE-së ka analizuar korrigjimin plotësues nr.41112DPR-9037112 datë 27.08.2015 të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se ky korrigjim nuk mund të paraqet gjendjen reale të konsumit të konsumatorit. Bazuar në këtë konstaton se për periudhën kontestuese përkatësisht periudhën 01-05/2015 konsumatori duhet të faturohet me shpenzimet e periudhës së njëjtë me njëhëni elektrik nr.50882395 pra periudhës 01/2016 deri në periudhën 05/2016.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike, listat e leximit si dhe korrigjimi plotësues nr.41112DPR-9037112 i datës 27.08.2015

Bordi i ZRRE bazuar në të gjitha shkresat, e veçanërisht rrjedhën e energjisë elektrik, procesverbalin e inspektimit nr.1037636 të datës 18.03.2014, procesverbalin mbi kontrollimin pranimit të grupit matës nr.004422 të datës 02.04.2015, procesverbalin e inspektimit nr.1750106 i të datës 27.01.2015, si dhe procesverbalin e pranimit të grupit matës nr.000005 i datës 10.07.2015 konstaton se për periudhën kontestuese përkatësisht periudhën 01-05/2015 konsumatori duhet të faturohet me shpenzimet e periudhës së njëjtë me njëhëni elektrik nr.50882395

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu. kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Gashi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: B.T
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.